

Zbatimi dhe forcimi i nismave ligjvënëse qytetare, përmes përmirësimeve ligjore dhe rritjes së aktivizmit të shoqërisë civile

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL) është duke zbatuar projektin me titull *“Zbatimi dhe forcimi i nismave ligjvënëse qytetare të parashikuara në kushtetutë, përmes përmirësimeve ligjore dhe rritjes së aktivizmit të shoqërisë civile”*, me mbështetjen e Fondacionit “Shoqëria e Hapur për Shqipërinë” (SOROS).

Projekti synon të rrisë aktivizmin e organizatave të shoqërisë civile për ushtrimin e nismave ligjore qytetare (nismës së drejtpërdrejtë ligjvënëse dhe nismës për referendum), përmes përmirësimeve legislative.

QNL po realizon këtë projekt me disa partnerë të rëndësishëm, bashkëpunimi me të cilët do të mundësojë rezultate në nivel kombëtar. Partnerët tanë janë Departamenti i të Drejtës Publike, Fakulteti i Drejtësisë, UT, si dhe fakultete të tjera pranë Universiteteve, Vlorë, Durrës, e Shkodër. Gjithashtu, janë partnerë të rëndësishëm disa OJF që kanë ndërmarrë nisma të ngjashme si, Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut, Res Publica, Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin në Vlorë, Qendra Komunitare Sot për të Ardhmen, Durrës, Qendra Gruaja tek Gruaja, Shkodër. etj. QNL do të mbështetet fort në eksperiencën e krijuar nga shoqëria civile shqiptare për ushtrimin e nismave ligjvënëse popullore.

Dy institute të spikatura të pjesëmarrjes së shtetasve në procesin ligjvënës të parashikuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë janë nisma ligjvënëse popullore (neni 81/1 i Kusht) dhe nisma popullore për referendum, të përgjithshëm e vendor (nenet 150 e në vijim dhe neni 108/4 të Kusht.).

Gjatë periudhës Korrik-Shtator 2015, QNL kreu një studim të situatës së këtyre instituteve dhe konstatoi mangësi të mëdha në legjislacion. Për mbledhjen e firmave për referendum, Kodi zgjedhor nuk vendos ndonjë garanci paraprake institucionale. Në Shqipëri, mbledhja e firmave sipas formularit të përgatitur nga vetë KQZ-ja, është detyrë private e nismëtarëve, pa asnjë mbikëqyrje apo autentifikim zyrtar. E njëjta situatë rezultoi edhe për nismën ligjvënëse popullore. Konkretisht, nuk ekziston një format ligjor për mbledhjen e firmave, të cilat duhet të vleftësohen nga ligji, përmes procedurave të qarta për depozitimin e tyre dhe krijimin e kushteve për subjektet që mbledhin firmat. Nuk ka parashikime për mënyrën e verifikimit të tyre, gjë që është përdorur nga autoritetet zyrtare për të frenuar nismëtarët. Këto mangësi kanë sjellë probleme në zbatimin në praktikë të instituteve të mësipërme.

Për më tepër ka një heshtje totale të të gjithë legjislacionit ndaj kontributit të organizatave të shoqërisë civile gjatë këtyre nismave, duke bërë që të humbasë krejt memoria historike e zhvillimit të nismës.

Mosgarantimi i këtyre nismave nga ligji dhe vështirësitë që krijohen për zbatimin e tyre, janë bërë shkas për mosinteresimin dhe ngadalësinë e shoqërisë civile për të ndërmarrë aksione të tilla, të cilat janë shumë të dobishme për ushtrimin e drejtpërdrejtë të demokracisë.

Mbi bazën e këtyre gjetjeve paraprake, mendojmë se ka nevojë për të rritur aktivizmin e organizatave të shoqërisë civile për të ndërmarrë nisma të tilla, si dhe për përmirësime ligjore, sidomos në aktet që vijnë:

1. Të hartohet ligj i posaçëm për nismën ligjvënëse popullore dhe në përputhje me të, të bëhen ndryshimet e nevojshme në Rregulloren e Kuvendit.
2. Të kryhen përmirësime të Kodit Zgjedhor, pjesa Referendumet (nenet 126-127).

Praktikat më të avancuara ndërkombëtare po shërbejnë në punën e grupit të ekspertëve që po punojnë me përgatitjen e projektligjeve përkatëse dhe do të orientojnë aktivitetet e projektit.

Nga zbatimi i projektit, do të rezultojë garantimi ligjor për ushtrimin e nismës ligjore nga 20000 zgjedhës, përmes hartimit të ligjit “Për nismën ligjvënëse qytetare”. Garantimi ligjor për mbledhjen e firmave, me qëllim ushtrimin e të drejtës për referendum, për shfuqizimin e një ligji, nga 50000 zgjedhës, përmes përmirësimeve të nevojshme në Kodin Zgjedhor, pjesa “Për Referendumet” do të përbëjë një tjetër rezultat të synuar të projektit. Në tërësinë e tij, projekti do të kontribuojë në përfshirjen e organizatave të shoqërisë civile në proceset për hartimin e nismave për ndryshime legislative.

Projektligjet e përgatitura nga një grup ekspertësh me përvojë do të bëhen pjesë e një diskutimi të gjerë, përmes organizimit të tryezave në Tiranë, Durrës, Vlorë, Korçë dhe Shkodër, para shqyrtimit të tyre pranë Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit të Shqipërisë, për miratim.

Çdo kontribut i aktorëve me eksperiencë të mëparshme në lidhje me institutet e nismës ligjvënëse popullore dhe nismës popullore për referendum, të përgjithshëm e vendor është i mirëpritur.

Ftojmë ekspertë, organizata të shoqërisë civile dhe aktorë të tjerë të bëhen pjesë e këtij procesi.